

KALLËZIM PENAL

- DREJTUAR:** Prokurorisë pranë Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë
- KALLËZUES:** Erion Veliaj, i biri i Luan dhe i Shqiponjë, i datëlindjes 17.12.1979, lindur dhe banues në Tiranë, aktualisht i paraburgosur pranë I.E.V.P. Durrës.
- OBJEKTI:** Fillimi i procedimit penal për kryerjen e veprës penale të "Falsifikimit të dokumenteve", parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal si dhe çdo veprë tjetër penale që rezulton gjatë hetimit.

I nderuar Drejtues i Prokurorisë,

Me vendimin nr. 228 (87-2025-359), datë 20.10.2025, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka vendosur mbi ankimin tim në mungesën time faktike dhe proceduriale, si dhe në mungesë të mbrojtësit tim ligjor. Ky vendim **nuk më është komunikuar asnjëherë personalisht**, as në mënyrë faktike dhe as në mënyrë juridikisht të vlefshme, pavarësisht se në momentin e marrjes së vendimit dhe vijimisht unë ndodhesha dhe ndodhem në kushtet e paraburgimit pranë Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Durrës, çka e bënte jo vetëm të mundur, por të detyrueshëm njoftimin tim personal përmes këtij institucioni.

Nga verifikimi i akteve të administruara në dosjen gjyqësore të Apelit rezulton se ekziston një dëftesë njoftimi e këtij vendimi (bashkëlidhur këtij kallëzimi), në të cilën figuron një nënshkrim i hedhur në emrin tim, duke krijuar artificialisht pamjen sikur unë të kisha marrë dijeni personalisht për vendimin gjyqësor. Deklaroj shprehimisht dhe në mënyrë të prerë se ky nënshkrim nuk është firma ime.

Kjo konstatohet drejtpërdrejt nga unë dhe konfirmohet objektivisht, pa asnjë dyshim, nga krahasimi me nënshkrimet e mia autentike, të depozituara në dokumente të tjera zyrtare, publike dhe private, të cilat janë lehtësisht të verifikueshme. Si rrjedhojë, dëftesa e

sipërpërmendur nuk pasqyron një akt real njoftimi, por përmban një element material të pavërtetë, të aftë për të prodhuar pasoja juridike, në veçanti fillimin fiktiv të afateve procedurale për ushtrimin e rekursit.

Për të verifikuar në mënyrë objektive dhe të pakontestueshme pretendimin e njoftimit, kam kërkuar zyrtarisht informacion nga Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Durrës, institucion në të cilin ndodhem i privuar nga liria. Me shkresën nr. 218 Prot., datë 14.01.2026, I.E.V.P. Durrës ka konfirmuar shprehimisht se vendimi i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nuk ka mbërritur asnjëherë në këtë institucion. Ky fakt administrativ, i provuar me akt zyrtar, e bën objektivist dhe juridikisht të pamundur marrjen e dijenisë nga ana ime për vendimin në fjalë, si person i izoluar, dhe përjashton çdo mundësi që njoftimi të jetë kryer në mënyrë të rregullt dhe të vlefshme.

Këto dy elemente të provuara, mungesa absolute e çdo njoftimi real dhe ekzistenca e një dëftese komunikimi me nënshkrim jo autentik në emrin tim, përbëjnë, të marra së bashku, provë të drejtpërdrejtë dhe të pakundërshtueshme se dëftesa e komunikimit është falsifikuar. Ky falsifikim është kryer me qëllim që të deformohet artificialisht fakti juridik i njoftimit mbi vendimin gjyqësor dhe të aktivizohet në mënyrë fiktive afati i ushtrimit të rekursit në Gjykatën e Lartë.

Ky veprim ka prodhuar dhe synon të prodhojë pasoja të drejtpërdrejta dhe rëndë cenuese mbi të drejtën time kushtetuese për të ushtruar rekurs, mbi sigurinë juridike, si dhe mbi vetë parimin e procesit të rregullt ligjor, duke synuar në thelb humbjen e së drejtës së rekursit përmes përdorimit të një akti zyrtar të rremë. Veprimet e përshkruara më sipër përmbushin në mënyrë të plotë dhe kumulative elementët përbërës të veprës penale të "Falsifikimit të dokumenteve", të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, pasi:

- është falsifikuar një dokument zyrtar, konkretisht një dëftesë njoftimi gjyqësor, e cila ka funksion të drejtpërdrejtë procedural;
- është hedhur një nënshkrim jo autentik në emrin tim, duke krijuar rrethanën e rreme të marrjes së dijenisë personale për vendimin gjyqësor;

- dokumenti i falsifikuar është përdorur për të prodhuar pasoja juridike konkrete, përkatësisht për të aktivizuar në mënyrë fiktive afatin e ushtrimit të rekursit në Gjykatën e Lartë, me synim humbjen e kësaj të drejte themelore procedurale.

Gjithashtu, nga hetimi i plotë dhe i pavarur i këtij fakti penal mund të rezultojnë edhe elementë të veprave të tjera penale, përfshirë, por pa u kufizuar në:

- **shpërdorimin e detyrës**, për shkak të përdorimit ose tolerimit të një akti të rremë në ushtrimin e funksioneve publike; në formën e **bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale**, në varësi të rolit konkret, dijenisë, qëllimit dhe interesit të personave që kanë hartuar, nënshkruar, administruar, përdorur ose kanë përfituar nga përdorimi i këtij dokumenti të falsifikuar.

Përcaktimi i përgjegjësisë penale individuale kërkon verifikimin e plotë të zinxhirit procedural të këtij akti, identifikimin e autorit ose autorëve të nënshkrimit jo autentik, si dhe të çdo subjekti publik që, me veprim ose mosveprim, ka kontribuar në prodhimin e pasojave juridike të këtij akti të rremë.

PËR SA MË SIPËR, KËRKOJ:

1. **Regjistrimin e menjëhershëm të procedimit penal** për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, si dhe për çdo vepër tjetër penale që mund të rezultojë nga hetimi;
2. **Administrimin në original** të dëftesës së komunikimit të vendimit gjyqësor (bashkëlidhur këtij kallëzimi), si provë materiale themelore e procedimit;
3. **Kryerjen e ekspertimit grafologjik** mbi nënshkrimin e hedhur në emrin tim në këtë dëftesë, për të verifikuar autenticitetin ose falsitetin e tij;
4. **Administrimin si provë objektive** të shkresës zyrtare të I.E.V.P. Durrës, e cila vërteton se vendimi gjyqësor nuk ka mbërritur asnjëherë në institucionin ku ndodhem i izoluar (bashkëlidhur);
5. **Identifikimin dhe hetimin penal** të çdo personi që, me veprim ose mosveprim, ka marrë pjesë në hartimin, nënshkrimin, administrimin, përdorimin apo përfitimin procedural nga


ky dokument i falsifikuar, përfshirë dhe pa u kufizuar edhe rastet e bashkëpunimit apo shpërdorimit të detyrës;

6. **Njoftimin tim të rregullt dhe të plotë** për çdo veprim procedural të kryer në kuadër të këtij procedimi penal, në përputhje me të drejtat e mia procedurale si kallëzues dhe palë e dëmtuar.

Ky kallëzim penal paraqitet paralelisht dhe në funksion të drejtpërdrejtë të mbrojtjes së së drejtës sime kushtetuese për rekurs, dhe një kopje e tij do t'i depozitohet menjëherë Gjykatës së Lartë, si provë se afatet procedurale për ushtrimin e rekursit nuk kanë filluar kurrë ligjërisht, për shkak të mungesës absolute të një njoftimi të vlefshëm dhe ekzistencës së një akti të rremë.

KALLZUES

Erion VELIAJ



I.E.P.V. DURRËS